

---

## **AKT THEMELIMI**

### **"Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Tiranës" SHPK**

#### **1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë**

Emri i shoqërisë do të jetë **"Universiteti i Shkencave të Aplikuara të Tiranës" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

#### **2. Ortaku i vetëm i shoqërisë është:**

- **"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.

#### **3. Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

**Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në fushën e edukimit, arsimit të lartë, kërkimit shkencor, si dhe studimeve e botimeve në sektorë të ndryshëm, duke përfshirë por pa u kufizuar në:**

**Themelimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve të arsimit të lartë në përputhje me legjislacionin e fushës;**

**Të ofrojë programe cilësore studimore Bachelor, Master, Doktoraturë, Postdokotaturë, Të Mesuarit Gjatë Gjithë Jetës (Life Long Learning) etj., sipas praktikave dhe përvojave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare, në fushat përkatëse duke u mbështetur në inovacionet me të fundit teknologjike me qëllim modernizimin e sistemit të lartë arsimor dhe përshtatjen e tij për nevojat e tregut ndërkombëtar të punës në ndryshim, nëpërmjet rritjes së lëvizjes së studentëve, pedagogëve, kërkuesve shkencorë dhe shkencëtarëve për shkëmbimin e përvojave me të mira midis institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri dhe jashtë saj;**

**Të ndërkombëtarizojë universitetin duke vendosur praninë ndërkombëtare dhe zgjerimin e veprimtarive universitare nëpërmjet partneriteteve strategjike, blerjeve ose hapjeve të degëve në vendet e targetuara;**

---

**Të ndërtojë një institucion inovativ të arsimit të lartë dhe me ndikim në mësimdhënie dhe kërkime, duke u shërbyer vlerave themelore njerëzore përmes prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të njohurive në nivel ndërkombëtar, si dhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe globale;**

**Të vendosë partneritete strategjike dhe transferim të njohurive në fushën e e-learning, teknologjive arsimore dhe lëvizshmërisë së studentëve me një kontribut më të madh në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;**

**Fuqizimin e bashkëpunimit ndërkombëtar të universitetit duke rritur nivelin e pjesëmarrjes në programet shkencore, kërkimore dhe programet e përbashkëta të BE-se dhe globale;**

**Themelimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e instituteve shkencore, laboratorëve shkencorë, qendrave shkencore, kërkimore dhe zhvillimore;**

**Themelimin, organizimin dhe mbarëvajtjen e kurseve dhe shkollave profesionale, kurseve parauniversitare, kurseve të ndryshme për gjuhë të huaja për degë të ndryshme për përgatitje për në universitet, si dhe përgatitje për provime ndërkombëtare;**

**Themelimin dhe administrimin e qendrave të ndryshme kulturore dhe studimore, si dhe ofrimin e mënyrave të ndryshme të arsimimit;**

**Botimin, importimin dhe ekspozimin e cdo lloj libri, reviste, broshure ose materiale të ndryshme për lëndët ose në ndihmë të tyre;**

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

#### **4. Selia e shoqërisë**

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

#### **5. Kohëzgjatja e shoqërisë**



---

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## 6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 2,000,000 (dy milion lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 2,000,000 (dy milion lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

## 7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

## 8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Z. Arben Breshani, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 28/12/1960, banuese në Tiranë, i identifikuar nga karta e identitetit me Nr. 033495628 dhe nr. personal G01228032H.**

## 9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

### ORTAKU I VETËM

**SHOQËRIA "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK**

Përfaqësuar nga: **Zj. Eda Spahiu**



[emër, mbiemër, firmë, vulë] - 19 / 12 / 2023